

## INFORMACION

**Mbi situatën higjiëno-sanitare të furnizimit me ujë të pijshëm në zonën e Marinzës, të rrethit të Fierit, në situatën emergjente të krijuar në këtë zonë pas shpërthimit të pusit të naftës**

Në situatën e krijuar në fshatin Marinëz të rrethit Fier, nga shpërthimi i pusit të naftës, një vëmëndje e veçantë i është kushtuar edhe furnizimit me ujë të pijshëm të popullatës, në kushtet e krijuara të emergjencës.

Për këtë në datën 02/04/2015 me urdhër të Drejtorisë së Institutit të Shëndetit Publik, Tiranë, një ekip specialistësh të Sektorit të Ujit dhe Sanitetit dhe Sektorit të Epidemiologjisë Ambientale dhe Cilësisë së Ajrit, shkuan në Marinëz për t'u njohur nga afër me situatën e furnizimit me ujë të pijshëm të banorëve të Marinzës dhe problemet e cilësisë së ajrit, të krijuar atje pas shpërthimit të pusit.

Në ndjekje të situatës edhe në datën 06.04.2015, një ekip specialistësh nga Sektori i Ujit&Sanitetit në Institutin e Shëndetit Publik, Tiranë, shkuan në Marinëz, për vlerësimin higjiëno-sanitar të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm, dhe cilësisë së tij.

Nga vrojtimet e specialistëve të kryera në sistemin ujësjellës, u konstaua se, si pasojë e shpërthimit të pusit të naftës, në fshatin Marinëz u dëmtua linja e ujësjellësit, pusët familjare, kolektori i ujrave të zeza, si dhe shumë gropa septike private, në zonën në afërsi të pusit të naftës, duke krijuar ndotje të lartë të ambientit dhe problematika të furnizimit me ujë të banorëve.

Shumë nga banorët e Marinzës, në të cilët u konstatuan dëmtime të puseve familjare, referonin se në momentet e vënies në punë të pusit për nxjerrjen e ujit, ndihej erë gazi.

Nga ana jonë u rekomandua që uji i puseve të mos përdoret për asnjë lloj shërbimi, si për pirje, përgatitje ushqimesh, higjiënë personale dhe për përdorim komunal.

Gjithashtu, u ndalua për furnizim publik (pirje, përgatitje ushqimesh, higjiënë personale) edhe uji i ujësjellësit të fshatit Marinëz.

Për furnizimin me ujë të pijshëm, si për pirje, përgatitje ushqimesh dhe higjiënë personale, u rekomandua të përdoret furnizimi me ujë nga autobotët. Uji i ujësjellësit u rekomandua të përdoret vetëm për përdorim komunal (larje ambientesh dhe WC).

Për këtë, nga ana jonë u përgatitën fletë -palosje me këshillat e nevojëshme mbi furnizimin me ujë dhe përdorimin e tij dhe u dërguan pranë Drejtorisë Rajonale të rrethit Fier, për t'u

Prania e MTBE në ujin e pijshëm edhe në nivelet e ulëta të tyre, shkaktojnë, ndryshime të vetive organoleptike të ujit (ndryshime të shijes dhe erës).

(bashkëngjitur materialit po përjellim rezultatet analitike të mostrave të ujrave për PAH , të ardhura nga FSHN);

✚ **Vlerësimi analitik për treguesit e Metaleve të Rënda:**

Nr.	Elementi	Pus-çpimi Nr. 1	Pus-çpimi Nr. 2	Ujë rrjeti 1	Norma (µg/l)	Max. e lejueshme (µg/l)
1	Plumb (Pb)	n.d	n.d	n.d	0	10
2	Kadmium (Cd)	n.d	n.d	n.d	3	5
3	Krom (Cr)	n.d	n.d	n.d	0	50
4	Bakër (Cu)	n.d	n.d	n.d	100	1000
5	Nikel (Ni)	n.d	n.d	n.d	20	50
6	Zink (Zn)	n.d	n.d	n.d	100	3000
7	Mangan (Mn)	<b>120</b>	<b>60</b>	14	20	50
8	Hekur (Fe)	<b>0.4</b>	<b>0.35</b>	n.d.	0.05 mg/l	0.3 mg/l

**Konkluzione:** Në analizën për treguesit e metaleve të rënda në mostrat e ujit të marra në burimet e ujit, (në pus-çpimin nr.1), mangani rezultoi në vlerat disa herë mbi max. e pranueshme të standartit shqiptar si dhe normave të BE-së, për cilësinë e ujit të pijshëm. Edhe në pus-çpimin nr.2 mangani rezultoi mbi vlerat max të lejueshme. Gjithashtu, edhe hekuri në të dy pus-çpimet rezultoi mbi vlerat max. të lejueshme.

Theksojmë se Mangani është një ndër elementët më të zakonshëm që gjëndet në tokë i bashkëshoqëruar nga elementi hekur, por në burimet e literaturës botërore bashkëkohore(WHO), theksohet se Mangani gjëndet në mjedis edhe nga shkarkime industriale, ku përmendet edhe shkarkimet të emetuara nga djegja e karburanteve.

Theksojmë se ekspozimet nga prania e manganit në ujë dhe në mjedis, shkakton efekte shëndetësore negative, duke shkaktuar dëmtime neurologjike të njohura si “Sindromi i Manganizmit” i cili karakterizohet si “ Sindroma e Parkinsonit” që karakterizohet me dobulesë trupore, anoreksi, dhimbje muskulare, apati, të folurit e ngadalshëm dhe monoton etj.

Treguesit e tjerë të mëtaleve të rënda nuk u detektuan.

✚ **Vlerësimi analitik për treguesit Vajra & Graso:**

Nr	Vajra e graso	Treguesi i analizuar	Limiti i detektimit të aparatit	Metoda e analizës

				CaCO <sub>3</sub>		
11	Amonjaku (mg/l)	25.8	1.54	0	0.05	ISO S SH EN 8467/2000
12	Nitrite (mg/l)	0.56	0	0	0.05	ISO S SH 6777/1984
13	Nitrate (mg/l)	3.96	3.96	25	50	Metoda me brucinë
14	Fortësia Totale (°gjermane)	85.4	12.6	10-15	20	ISO S SH 6059/84
15	TDS (mg/l)	6245	740	500		S SH EN 27888/01
16	Fosfate (mg/l)	4.2	2.4	0.4	2.5	ISO S SH 6878/2004
17	Lënda organike (mg/l)	36	10	1	3	ISO S SH 2639-15/1989
18	Kloruret (mg/l)	148	117	25	200	ISO S SH 9297/89
19	Sulfatet (mg/l)	120	98	25	250	-
20	Magneziumi (mg/l)	139	30	20	50	S SH 2639-4/89

*Konkluzione: Nga analiza e të dy mostrave të ujrave të analizuara në laborator, rezulton se uji është jashtë standartit shqiptar aktual në fuqi (VKM Nr. 145, datë 26.02.1998), si dhe Direktivës 98/83/ BE , për ujrat që përdoren për konsum njerëzor.*

#### **KONKLUZIONE**

- **Nga rezultatet analitike të deritanishme, të përshkruara më sipër, aktualisht, uji i ujësjellësit të fshatit Marinëz, nuk mund të përdoret për furnizim publik (pirje, përgatitje ushqimesh, higjienë personale), por vetëm për përdorim komunal (larje ambjentesh dhe WC), deri në përmbushjen e kërkesave të cilësisë së ujit, sipas standartit shqiptar aktualisht në fuqi dhe Direktivave të BE-së.**
- **Burimet ujore, nuk janë të mbrojtur, mungojnë brezat sanitare;**
- **Në ujësjellës, mungon sistemi i klorinimit, për arritjen e një dezinfektimi të sigurtë të ujit të pijshëm.**

Si rezultat ekspozimi ndaj ndotësve të ajrit kryesisht të emetuara nga komponimet e hidrokarbureve lejon zhvillimin e një sërë simptomash në rrugët e frymëmarrjes. Rezultatet e përfuara nga të dhënat lidhur me praninë e ndonjë pjestari të familjes me probleme astmatike 19% e familjeve deklarojnë se kanë të sëmurë me astmë bronchiale të konfirmuar dhe trajtohen nga mjeku specialist. Numri mesatar i rasteve me astmë bronchiale në familje është  $1,15 \pm 0,3$  raste. Në total janë 22 raste të raportuara me astmë bronchiale në familjet e përfshira në studim.

Grafiku. 10

Përqindja e rasteve me probleme të mushkrive gjatë 12 muajve të fundit




Figura 10 gjithashtu, prezanton rastet e raportuara me probleme pulmonare gjatë 12 muajve të fundit. Në 51% të familjeve të përfshira në studim shfaqin probleme të herë pas herëshme pulmonare.

**Tabela 4 Rezultatet e fenol urisë në banorët e fshatit Marinës**

<b>N r</b>	<b>Gjinia</b>	<b>Mosh a</b>	<b>Profesio ni</b>	<b>Rezultati në mg/gr</b>	<b>Norma *</b>
1	Femër	37	Shtëpiak e	154	80
2	Mashku ll	49	Naftëtar	168	80
3	Mashku ll	56	Naftëtar	175	80
4	Mashku ll	51	Bujk	140	80
5	Femër	32	Parukier e	168	80
6	Mashku ll	61	Naftëtar	170	80
7	Mashku ll	36	Naftëtar	120	80
8	Femër	13	Nxënëse	158	80

\*Norma i referohet punonjësve të naftës për 8 orë punë dhe 5 ditë pune

\* Vërehet se në të gjitha rastet e analizave pavarësisht gjinisë, moshës dhe profesionit, vlerat e fenol urisë janë mbi normë. Rastet e meshkujve me profesion naftëtar, kanë disa muaj që janë të pa punë dhe nuk ekspozohen me nga vendi i punës.

Prania e vlerave mbi normë të fenolit në urinë tek banorët e fshatit, të cilët nuk punojnë në industrinë e naftës tregojnë për praninë dhe e gazeve të biomasës si dhe ekspozimin e popullatës në zonën e banuar.

## Rezultatet e Analizimit të kampionëve të tokës

### Mostra Nr.146

Lloji i mostres: ..Tokë kampioni parë - 150m nga pusët e shpërthimit

Seksioni dërgues ose kodi i seksionit: Seksioni i Epidemiologjisë Mjedisore dhe Kontrolli i Cilësisë së Ajrit

Data e pranimit për analizë: 18.04.2015

Kodi i pranimit në laborator: 17418042015

Pranuesi i Mostrës: Zh. Josifi

Data e përfundimit të analizës: 27.04.2015

Tabela 8

Nr	Treguesit e analizuar	Vlera e analitit mg/kg peshë të thatë.	Metoda e analizës	Limiti i dedektimit	shënime
1	Pb (Plumb)	13.7	ISO 11460 ISO 11047	0.06 µg/l	
2	Cd(Kadmium)	n.d	ISO 11460 ISO 11047	0.006 µg/l	
3	Cr(Krom)	101	ISO 11460 ISO 11047	0.05 µg/l	
4	Zn (Zink)	123	ISO 11460 ISO 11047	0.004µg/l	
6	Ni(Nikel)	86.7	ISO 11460 ISO 11047	0.2 µg/l	
7	Cu(Baker)	29.2	ISO 11460 ISO 11047	0.04 µg/l	

Rezultatet e niveleve të elementëve që përbejnë metalet e rënda në kampionin e parë të marrë në 150 m nga pusët e shpërthimit tregojnë vlera në normë përveç nivelit të nikelit i cili duhet të jetë në vlerat 30-75 mg/kg peshë të thatë.

### Mostra Nr.147

Lloji i mostrës: Tokë kampioni dytë brënda zonës së shpërthimit

Seksioni dërgues ose kod i seksionit: Seksioni i Epidemiologjisë Mjedisore dhe Kontrolli i Cilësisë së Ajrit

Data e pranimit për analizë: 18.04.2015

Kodi i pranimit në laborator: 17518042015

Pranuesi i Mostrës: Zh. Josifi

Data e përfundimit të analizës: 27.04.2015

Nr	Treguesit e analizuar	Vlera e analitit mg/kg peshe te thate.	Metoda e analizës	Limiti i dedektimit	shenit
1	Pb (Plumb)	20.5	ISO 11460 ISO 11047	0.06 µg/l	
2	Cd(Kadmium)	n.d	ISO 11460 ISO 11047	0.006 µg/l	
3	Cr(Krom)	145.1	ISO 11460 ISO 11047	0.05 µg/l	
4	Zn (Zink)	137	ISO 11460 ISO 11047	0.004µg/l	
6	Ni(Nikel)	97.2	ISO 11460 ISO 11047	0.2 µg/l	
7	Cu(Baker)	31.2	ISO 11460 ISO 11047	0.04 µg/l	

Edhe në kampionin e dytë të marrë brënda zonës së shpërthimit nivelet e pranisë së elementëve tmetaleve të rënda është në vlera normë përveç elementit nikel i cili gjëndet mbi normë (norma 30-75 mg/kg peshë e thatë) dhe kromi në afërsi të limitit të lejuar (20-150 mg/kg peshë e thatë).